

Kushtet e posaçme të lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë dhe mirëmbajë me shpenzimet e veta pajisjet për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organi përkatës që ka lëshuar lejen;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit ujqor për hidroenergji, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo vepre marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujqore;
8. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujqore;
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes;
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
11. Të lejojë rrjedhën ekologjike, sipas specifikimeve në leje;
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujqor në rast të një aksidenti, apo incidenti;
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujqor në gjendjen e mëparshme;
14. Të mos cënojë faunën dhe florën ujqore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasimore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujqor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur;
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet e tjera për veprimtarinë, të përcaktuara në ligjin për burimet ujqore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ISHËM

Nr. Serial 000095

LEJE
PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR

Nr. 51/ Prot., datë 12/01/20
20 Miratuar me:

VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT LUMOR ISHËM

Nr.18, datë 22/12/2025

Emri i individit/subjektit: "TIRANA DUE" SH.P.K
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT): J91916002F
Baseni Lumor: ISHËM
Kodi i Trupit Ujor: -
Qarku: TIRANË
Bashkia/ Njësia administrative: BASHKIA TIRANË
Koordinatat: X= 478433.20 Y= 4580265.57 Z= 102 m
Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji : PËR QËLLIME SANITARE
Prurja mesatare vjetore: $q_{mes} = 1 \text{ l/s}$
Prurja ekologjike: NUK KA
Sasia e ujit që jepet për përdorim: $q_{nog} = 1 \text{ l/s}$
Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka): NUK KA
Vendi ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer: NUK KA
Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: Lumi Lana
Sipërfaqja e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes) NUK KA
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): SIPAS KUSHTEVE TË LEJES
Periudha e vlefshmërisë: 5 VJET
Hyrja në fuqi: Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licensave dhe lejeve

KRYETARI

EMILJAN JANI

